

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Ardian Ajvazi, në çështjen juridike, sipas padisë së paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna e [REDACTED] kundër të paditurës Drejtoria e Administratës dhe Personelit në Ferizaj, të cilën me autorizim e përfaqëson Sami Vranovci, për shkak të anulimit të konkursit dhe kompensimi i pagave si mësimdhënës prej momentit të pranimit të kandidatëve e gjerë në pranimin tim në vendin adekuat, në seancën publike të mbajtur me datë 08.06.2016, merr këtë:

AKT GJYKIM

I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpasdia e paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e [REDACTED] e ushtruar kundër të paditurës Drejtoria e Administratës dhe Personelit në Ferizaj, lidhur me kompensimin e të ardhurave personale, për shkak të anulimit të konkursit dhe kompensimi i pagave si mësimdhënës prej momentit të pranimit të kandidatëve e gjerë në pranimin e paditësit në vendin adekuat.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Arsyetimi

Paditësi me datë 27.09.2012, ka parashtruar padi, kundër të paditurës, për shkak të anulimit të konkursit dhe kompensimi i pagave si mësimdhënës prej momentit të pranimit të kandidatëve e gjerë në pranimin e paditësit në vendin adekuat.

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi me padi dhe seancat e mbajtura ka theksuar e paditura ka shpallur konkurs me datë 06.07.2012, për vendin e punës në Shkollën e Mesme-Gjimnazin "[REDACTED]" në Ferizaj për dy mësimdhënës për informatik; në Shkollën e Mesme-Gjimnazi "[REDACTED]" në Ferizaj për dy mësimdhënës për informatik. Për këto vende të punës janë pranuar

kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet ligjore. Meqënese paditësi pretendon se i plotëson kushtet ligjore i ka propozuar Gjykatës që ta aprovonë kërkesëpadinë e paditësit duke e anuluar konkursin e shpallur me detyrim që e paditura t'ia kompenzojë pagat paditësit prej momentit të pranimit të kandidatëve të tjerë e gjerë në momentin e pranimit të paditësit në vendin adekuat.

E paditura përmes të autorizuarit të saj, në përgjigje në padi dhe seancat e mbajtura ka theksuar se vlerësimi i komisionit për kandidatët është mbështetur në ligj dhe në bazë të konkursit, në të cilin janë parapa edhe kushtet dhe kriteret e pranimit, andaj i ka propozuar Gjykatës ta refuzonë në tërsi kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes, për aq sa palët ndërgjyqëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, Gjykata ka administruar një sër provash: Vendimi nr.02111-58143 i datës 29.08.2012; ankesa e dt.22.08.2012; Lista e kandidatëve të pranuar në shkollat e mesme; Konkursi plotësues i datës 06.07.2012 me numër 205/04; Regjistri i kërkesave të pranuar për punësim i datës 06.07.2012; Formularët e vlerësimit të kandidatëve të datës 09.08.2012; Njoftimi i datës 06.07.2012; Njoftimi i datës 01.08.2012 me numër 230-04; Njoftimi mbi rezultatet e konkursit plotësues i datës 15.08.2012; Procesverbali i Inspektoratit të Punës i Ministrisë ë Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë i datës 28.09.2012; Vërtetimi i datës 17.05.2016, Diploma e paditësit [redacted] me numër 185.

Baza ligjore

Në nenin 2.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore parashihet se "Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse". Në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 parashihet paragrafi 1 "Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës". Paragrafi 2. "Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siç parashihet me këtë ligj dhe aktet tjera në fuqi". Në nenin 79 të të njejtit ligj parashihet "Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente".

Vlerësimet juridike dhe faktike të çështjes

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve dhe provave të lartë cekura, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është tërësisht e pabazuar. Vlerësimi i Gjykatës është se konkursi plotësues i datës 06.07.2012 nuk është i pavlefshëm sepse kushtet e

parapara në te kanë qenë të barabarta për të gjithë kandidatët, për këtë arsye Gjykata nuk mund ta anulojë konkursin. Po ashtu Gjykata për kompenzimin e pagave si mësimdhënës prej momentit të pranimit të kandidatëve e gjerë në pranimin e paditësit në vendin adekuat, nuk mund ta aprovojë për arsye se paditësi asnjëherë nuk ka punuar në vendin e punës, për të cilin kërkon kompenzimin e pagave, këtë kërkesë mund ta bëjë eventualisht kur i ndërprehet pa të drejtë marrëdhënia e punës. Paditësi është dashur në procedurën civile ta kontestojë vendimin mbi përzgjedhjen e kandidatëve e jo konkursin.

Nga faktet e treguara në padinë e paditësit si dhe nga provat dhe shkresat që gjenden në lëndë, rezulton si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit. Gjykata vërtetoi se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për të vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, e duke u bazuar në nenet 143 dhe 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.509/12, me datë 08.06.2016



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të kopjes së tij, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e të dorëzohet përmes kësaj Gjykate. Afati fillon të rrjedh nga dita e nesërme pas pranimit të këtij Aktgjykimi.

REPUBLIKA E KOSOVËS



REPUBLIKA E KOSOVËS

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JË PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ / UROŠEVAC

